



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. I prot. 2406 Më 02.07.2016
Br. prot. Dt. 2016
RAHOVEC - ORAHOVAC



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

**Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam
Department of Economy, Development and Tourism**

Raporti i punës

Janar – Qershor, 2026



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



**Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam
Department of Economy, Development and Tourism**

DATË /A:	04.06.2026
PËR/ZA/TO :	z.Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit
NGA/OD/FROM:	z.Altin Zhuniqi, Drejtor për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport i punës për periudhën Janar-Qershor 2026

Gjatë periudhës janar-Qershor 2026, Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm ka zhvilluar aktivitete të ndryshme:

- Ne 6 mujorin e pare te këtij viti prioritet ka qene inkasimi i borxheve te mbetura nga vitet paraprake ne sektorin e taksave afariste dhe qerase.

Gjate kësaj periudhe jane bere dërgesat e aktvendimeve per te gjitha bizneset te cilat ngarkohen me takse afariste sipas rregullores 01 NR 80/20

- Në këto 6 muaj , kemi vazhduar me vizita të ndryshme bizneseve lokale, shoqatën Enologjia dhe Shoqaten e Afaristeve ne Rahovec. Në këto takime kemi diskutuar të arriturat dhe sfidat e bizneseve si dhe vazhdimin e bashkëpunimit me insitucionet publike. Ne muajin Shkurt janë dërguar 5 biznese lokale ne prodhim ne tekstil, ne panairin me te madh ne Evrope qe eshte mbajtur ne Stamboll – Turki.

- Po ashtu janë monitoruar projektet kapitale, jemi ne komunikim i vazhdueshëm me ministritë e linjës për të gjitha projektet që kemi në bashkëfinancim, jemi kujdesur për mirëmbajtjen e shtigjeve të ecjes dhe eshte bere finlizimi i zyrës se Turizmit te Stacioni i Autobusave.

- Eshte perfunduar plotësim- ndryshimi i rregullores per Taksa Komunale (ne nr 01/80)

- Kemi mbajt takim me MINT – Ministria e Industrise, Ndermarresise dhe Tregtise lidhur me Parkun e Biznesit ne Opterushe, ministrja znj. Mimoza Kusari Lila u zotua qe punimet do te fillojnë brenda 2 muajve.

- Kane vazhduar punimet te Kroi Demirit ne Drenoc, ku finalizimi i projektit pritet te behet ne muajin Korrik.

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

- Ne muajin Qershor, Komuna e Rahovecit ka aplikuar dhe ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal (MZHR) për realizimin e projektit të rëndësishëm që përfshin: Ndriqim publik, krijimin e hapësirave të gjelbra, parkun rekreativ, shteg të ecjes dhe infrastrukture për agroturizem, me një vlerë totale prej 453.884.00 Euro

- Gjatë kësaj periudhe, DEZHT ka përgatitur disa pika drejtuar Kuvendit Komunal në Rahovec:

- Propozimi për dhënie në shfrytëzim të lokalit të Parkut Qytetit
- Propozimi për dhënie në shfrytëzim të lokalit në rrugën Avudall Bugari 30m2
- Propozimi për dhënie në shfrytëzim afatgjatë, përmes shprehjes së interesit të pronës komunale Hotel Park Plaza
- Propozimi për plotësim – ndryshimin e rregullores për Taksa Komunale.
- Propozim për dhënie në shfrytëzim afatshkurte të lokaleve afariste në palestrën sportive Mizahir Isma - Rahovec.

Sektori për Ekonomi:

-Në 6 muajin e parë të vitit 2026, janë përgatitur aktvendimet për të gjitha bizneset të cilat sipas kodeve ekonomike ngarkohen me taksë afariste, në total janë shpërndarë 847 aktvendime, dhe janë dërguar 286 Verejtje.

Të hyrat dhe ngarkesa në taksë komunale;aa

Nr.	Përshkrimi	2025	2026	Rritja në %
1	Të hyrat në taksë komunale Janar – Qershor	€ 31.857.50	€ 63.021.50	97.82%

Sektori për Zhvillim;

-Evidenca e të hyrave dhe ngarkesës së qirasë të lokaleve afariste dhe pronës së paluajtshme të Komunës së Rahovecit, sipas bazës së shfrytëzimit si pasuri e paluajtshme komunale me të cilat disponon komuna e Rahovecit, mbahet në mënyrë të rregullt.

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

- Komuna e Rahovecit, respektivisht Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm i menaxhon gjithsejtë 42(dyzet e dy) kontrata

Në periudhën janar - Qershor 2026, janë lëshuar gjithsej 33 pëlqime të punës dhe janë dërguar me kohë vërejtje për të gjitha bizneset të cilat kanë pasur vonesa në pagesat e qirasë, konform dispozitave ligjore që përcakton rregullorja për taksa komunale 01 NR: 80/20

Të hyrat nga qiratë;

Nr.	Përshkrimi	2025	2026	Rritja ne %
1	Të hyrat nga qiratë, Janar- Qershor	€ 25.474.64	€ 40.761.97	60 %

Zyra e QKRB-së:

-Raporti është i bazuar në planifikimin, objektiva dhe detyrat e punës. Evidenca e regjistrimit të bizneseve të komunës së Rahovecit, sipas bazës së programit online të ARBK-së, mbahet në mënyrë të rregullt.

Tabela e kërkesave dhe e regjistrimit të bizneseve për periudhën janar- Qershor 2026:

Nr.	Përshkrimi	Nr.
1	Biznese të reja	25
2	Biznese të reja SH.P.K	49
4	Informata të Bizneseve	64
5	Shuarje të biznesit	9
6	Lëndë të anuluar	0
7	Çerteikata duplikat	6
8	Historiat Biznesi	0
9	Ndryshime në biznes	45
10	Vërtetim individual	2
	Gjithsej lëndë të përfunduara	200

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Menaxhimi i Asteteve komunale

Gjatë periudhës janar – qershor 2026, Sektori për Menaxhimin e Aseteve ka kryer një sërë detyrash dhe proceseve të rëndësishme në funksion të menaxhimit dhe administrimit të pasurive komunale. Ky raport pasqyron punën e realizuar, duke përfshirë përditësimin e të dhënave në sistemet zyrtare, krijimin e bazës së të dhënave, evidentimin e pasurive jashtë përdorimit, identifikimin e automjeteve jashtë përdorimit dhe realizimin e procedurës së shitjes së tyre.

Po ashtu, gjatë periudhës raportuese ky sektor ka kryer këto aktivitete:

Përditësimi i të dhënave në SIMFK dhe krijimi i bazës së të dhënave

Një nga aktivitetet kryesore ka qenë përditësimi dhe përpunimi i të dhënave në sistemin SIMFK, ku janë sistemuar të gjitha të dhënat për pasuritë sipas klasifikimit përkatës. Janë përfshirë edhe të dhënat e viteve paraprake, duke siguruar saktësi dhe përditësim të regjistrave kontabël. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe është krijuar një bazë e të dhënave në Excel, e cila shërben si arkiv digjital dhe mjet ndihmës për menaxhim dhe raportim më efikas të pasurive komunale.

Evidentimi i pasurive jashtë përdorimit

Gjatë muajit mars 2026 është realizuar evidentimi i pasurive jo financiare jokapitale jashtë përdorimit në institucionet komunale, përfshirë shkollat, administratën komunale dhe QKMF. Ky proces ka përfshirë identifikimin dhe regjistrimin e pasurive që nuk janë më funksionale ose nuk përdoren, me qëllim krijimin e një pasqyre të saktë mbi gjendjen reale të tyre.

Identifikimi i automjeteve jashtë përdorimit

Me vendim të Kryetarit të Komunës është formuar komisioni për identifikimin dhe regjistrimin e automjeteve jashtë përdorimit. Pas verifikimeve në terren, janë identifikuar gjithsej 9 automjete jashtë përdorimit. Më pas është zhvilluar procedura e shitjes përmes 9 loteve. Nga kjo procedurë janë shitur 7 lote, ndërsa Loti 1 dhe Loti 7 kanë mbetur të pashitur. Të hyrat e realizuara nga shitja e automjeteve kanë arritur vlerën prej 6,532.00 €, duke kontribuar në menaxhimin më efikas të pasurisë komunale.

Nr.	Data	Shuma
1	Loti 2,3,9	1,409.00 Euro
2	Loti 6	1,107.00 Euro
3	Loti 4,5	1,015.00 Euro
4	Loti 8	3,001.00 Euro
TOTALI		6,532.00 Euro

KOMUNA RAHOVEC

Sektori i Turizmit

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2026, Zyra për Informacione Turistike (TIC), në kuadër të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm (DZHET) në Komunën e Rahovecit, ka zhvilluar aktivitete të rëndësishme me qëllim avancimin e turizmit lokal, forcimin e bashkëpunimit institucional dhe krijimin e bazës strategjike për zhvillim të qëndrueshëm-

Fokus i veçantë i është kushtuar zhvillimit të turizmit të verës, përmes kontakteve të vazhdueshme me veraritë dhe bodrumet lokale. Si e tillë, më 26 Mars 2026 është mbajtur një takim me rreth 10 prodhues të verës, ish anëtarë të Task Forces, ku është diskutuar për marketingun, promovimin dhe riaktivizimin e bashkëpunimit publiko-privat në këtë sektor. Po ashtu, bashkëpunimi me Shoqatën “Enologjia” ka vazhduar në drejtim të pjesëmarrjes në panairë ndërkombëtare dhe organizimit të aktiviteteve të përbashkëta.

Një arritje e rëndësishme ka qenë ri-funksionalizimi i Zyrës së TIC-ut, përmes sigurimit të hapësirës në Stacionin e Autobusave në Rahovec dhe bartjes së aseteve përkatëse. Zyra aktualisht është pjesërisht funksionale dhe pritet funksionalizimi i plotë pas zgjidhjes së çështjes së furnizimit me energji elektrike.

Në aspektin e bashkëpunimit institucional, janë zhvilluar kontakte me organizata si UNDP, KIESA dhe KFOR, si dhe është hartuar dhe dorëzuar një projekt për promovimin e turizmit. Po ashtu, është iniciuar bashkëpunimi me Bashkinë e Lushnjës për zhvillim të përbashkët në fushën e agroturizmit.

Në planin strategjik, është përditësuar Plani i Punës së TIC-ut 2026–2028 dhe është hartuar projekti “Zbulo Rahovecin – Promovimi i Turizmit”. Paralelisht, është iniciuar procesi për ribrendimin e sektorit të turizmit përmes nisjes së procedurave të prokurimit për dizajnim të logos së TIC-ut dhe për hartim të Termave të Referencës përkatëse. Gjithashtu, janë ndërmarrë hapa për zhvillimin e Planit për Trashëgimi Kulturor dhe për identifikimin e projekteve në fushën e agroturizmit dhe turizmit rural.

Në fushën e promovimit, janë zhvilluar aktivitete për përgatitjen e materialeve turistike dhe krijimin e platformës digjitale “Rahovec Tourism”, si dhe janë shqyrtuar mundësitë për pjesëmarrje në panairë turistike.

Në aspektin administrativ, TIC ka kontribuar në ristrukturimin e brendshëm të DZHET-it dhe në përditësimin e pikave turistike në përputhje me udhëzimet administrative për sinjalizimin turistik.

Më tutje, vlen të theksohet takimi i realizuar me verarinë “LabiWine” dhe pronarin e saj, Z. Labinot Shulina, i cili në Maj, 2026 u zgjodh kryetar i ri (me mandat të plotë) i Shoqatës “Enologjia”. Kryetari i ri e mirëpriti takimin me Drejtorin e DZHET-së dhe zyrtaren e TIC-ut, ku u diskutua mbi vazhdimin e bashkëpunimit dhe thellimin bashkëpunues ndërmjet shoqatës dhe Komunës së Rahovecit. Ndër pikat kyçe të diskutimit ishin: mundësitë e mirëmbajtjes së “Shtëpisë së Verës”, organizimi i ngjarjeve të përbashkëta për promovimin e verës dhe turizmit në nivel lokal dhe ndërkombëtar

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Marrëdhëniet Ndërkombëtare (Kontakti me Burundin):

Në Maj, 2026, është krijuar kontakti zyrtar me Ministrinë e Turizmit të shtetit të Burundit. Ky kontakt fillestar erdhi si rezultat i bashkëpunimit të Burundit me Z. Baki Hoti, përfaqësues i Shoqatës së Turizmit të Kosovës me seli në Prishtinë. Drejtori i Zyrës së Turizmit të Burundit, Z. Bruce Niyonzima, ka kontaktuar Drejtorin e DZHET-së, Z. Altin Zhuniqi, gjë që mundësoi realizimin e një takimi virtual midis zyrtares së Turizmit të Rahovecit dhe përfaqësuesve të Burundit.

Gjatë këtij takimi, Z. Niyonzima shpalosi Strategjinë e Turizmit të Burundit, ku Kosova dhe specifiku i Rahovecit është përdorur si model i praktikave më të mira për zhvillimin e turizmit në vendin e tyre. Aktualisht, vazhdimësia e këtij bashkëpunimi mbetet për t'u konfirmuar për shkak të disa vështirësive teknike që zyra e tyre e turizmit ka shfaqur në komunikimin elektronik me Komunën e Rahovecit. Megjithatë, TIC-u dhe Komuna e Rahovecit mbeten plotësisht të hapur për bashkëpunim në kuadër të zhvillimeve turistike në nivel të marrëdhënieve ndërkombëtare.

Në përfundim, ky 6 mujor karakterizohet nga hapa konkret në drejtim të konsolidimit institucional, forcimit të bashkëpunimit dhe krijimit të kushteve për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit në Komunën e Rahovecit.

Drejtor i DEZHT



KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm